



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 214/8 prot.

Tiranë, 19.4.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 112, datë 4.3.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Komisionit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për djeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 8.4.2019, është njoftuar vendimi nr. 112, datë 4.3.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Dritan Peka, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 112, datë 4.3.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Peka, ushtron detyrën e prokurorit/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim referuar si GPPP), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin z. Dritan Peka”¹, ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin, ka referuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Peka”.²

2.3 **GPPP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin³ për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Peka.

3. Komisioni, pas hetimit administrativ mbi kriteret e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Peka, ka plotësuar së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit 84/2016 dhe ka vendosur “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Dritan Peka, me funksion prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.

II. Shkaqet e ankimit

4. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).

5. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si: Kolegji).

¹ Shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë ***.1.2018.

² Shkresa e DSIK-së me nr.*** prot., datë ***.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendim të K.D.ZH-së nr. *** , datë ***.2.2018).

³ Raport i Prokurorisë së Përgjithshme nr.*** prot., datë ***.4.2018.

6. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore, që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës, nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e këtij të fundit, pa pasur mundësinë ai vetë (Komisioneri) që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.
7. Në të tilla rrethana ligjore, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit.
8. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, bazuar në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 112, datë 4.3.2019, dhe provave të administruara për këtë qëllim nga *Komisioni*, vlerëson se vendimi përmban shkaqe të mjaftueshme për t'iu paraqitur juridiksionit rishikues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit për vendimmarrje.
9. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 112, datë 4.3.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II. A Vlerësimi për kriterin e pasurisë

10. Gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit, kontroll dhe vlerësim i kriterit të pasurisë për subjektet që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin dhe hetimin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, kontrollin e pasurisë, ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj dhe i përmbushjes së detyrimeve të ligjshme financiare.
11. **Për pasurinë nr. 1, apartament banimi me sip. 94.6 m², i ndodhur në Tiranë**
 - 11.1 **Në Deklaratën “Vetting”, subjekti dhe personi i lidhur⁴ ka deklaruar:** Apartament banimi me sip. 94,6 m², ndodhur në rrugën “***.***”, pall. “****”, shk.***, ap. *** , Tiranë. *Vlera* 49.440 USD (dyzet e nëntë mijë e katërqind e dyzet). *Pjesa takuese*: 50%. *Burimi i deklaruar i të ardhurave për banesën* : (i) kredi dhe (ii) të ardhura nga paga.
 - 11.2 **Në Deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie (deklarata fillestare)**, dorëzuar më datë ***.3.2004, subjekti i rivlerësimit në Formularin A-8, “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka deklaruar:

⁴ Znj. ***.***, si bashkëshorte e subjektit të rivlerësimit dhe person që mbart detyrimin për deklarim si nëpunës publik në zbatim të ligjit 9049/2003.

- Kontratë porosie për blerje apartament banimi nga shoqëria “****” sh.p.k., Tiranë. *Vlera* 5.206.700 lekë. *Arsyeja e krijimit të detyrimit* : Prenotim apartamenti në pallatin e ndërtuar nga shoqëria. *Vërejtje*: Pallati nuk është hipotekuar, ndaj nuk është bërë shit-bletje.

- Kontratë marrje kredie, me vlerë 3.660.000 lekë, marrë në ****.***.***. *Arsyeja e krijimit të detyrimit*: Kredia është marrë për të paguar detyrimin në kontratën e porosisë për apartamentin.

11.3 *Në deklaratën fillestare dhe deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë për vitet 2004 dhe 2005* nuk rezulton asnjë deklaram lidhur me pagesat e kësteve⁵ të kësaj pasurie si detyrim për deklaram.

11.4 Për sa më sipër, nga deklaramet, *burimi i krijimit të kësaj pasurie* rezulton të ketë mospërputhje midis Deklaramës “Vetting” me deklaramat e interesave pasurorë privatë/vjetorë.

11.5 *Në fashikull të Komisionit ndër të tjera është administruar:*

- i. Kontratë porosie nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2002, e lidhur para noterit ***.***, Zyra e Noterisë Tiranë, me palë z. Dritan Peka, *Porositës* dhe shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., *Sipërmarrësi*;
- ii. Kontratë shitblerje nr.*** rep., nr. *** kol., e datës ***.5.2012, e lidhur para noterit ***.***, Zyra e Noterisë Tiranë, me palë shoqërinë “****” sh.p.k., *Shitësi* dhe z. Dritan Peka dhe znj. ***.***, *Blerësit*;
- iii. Kontratë kredi bankare dhe vënie në hipotekë pasurie të paluajtshme me nr.*** rep. *** kol., datë ***.5.2003, me *Kredihënës* ***.***.*** (***) , *Bashkëkredimarrës* Dritan e *** Peka ;
- iv. “Certifikatë për vërtetim pronësie” për apartament me sipërfaqe 94,6 m², me nr. pasurie *** , Z. K. *** , rr: “****.****”, Tiranë, në bashkëpronësi të z. Dritan Peka dhe znj. ***.***, me nga ½ pjesë takuese gjithsecili;
- v. Fotokopje mandat arkëtimi, nr.***, datë ***.5.2005, në vlerën 1.740 USD, nr.***, datë ***.11.2004, në vlerën 4.000 USD, nr.***, datë ***.11.2003, në vlerën 1.700 USD, nr.***, datë ***.5.2003, në vlerën 12.000 USD, nr.***, datë ***.5.2003, në vlerën 20.000 USD dhe nr.***, datë ***.12.2002, në vlerën 10.000 USD.

11.6 Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga kontrata e porosisë nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2002, me Porositës z. Dritan Peka, dhe Sipërmarrës shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k, dhe më pas kontrata e shitblerjes nr.*** rep., nr.*** kol., e datës ***.5.2012, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë blerëse z. Dritan Peka dhe znj. ***.***, për apartamentin me sipërfaqe 94,6 m², me vendndodhje në rrugën “****.****”, Tiranë, për çmimin prej 49.440 USD.

⁵ Mandat arkëtimi, nr.***, datë ***.5.2005, në vlerën 1.740 USD, nr.***, datë ***.11.2004, në vlerën 4.000 USD, nr.***, datë ***.11.2003, në vlerën 1.700 USD.

- 11.7 Në kontratën e porosisë është parashikuar edhe mënyra e pagesës së këtij apartamenti, ku me nënshkrimin e saj, *Porositësi* do t'i paguajë *Sipërmarrësit* shumën prej 10.000 USD, dhe deri në dorëzimin e apartamentit (me çelësa në dorë) do të paguhet edhe 29.440 USD, ndërsa pjesa e mbetur, prej 10.000 USD, do të paguhet në afatin kohor prej gjashtë muajsh nga data e hyrjes në apartament.
- 11.8 I pyetur nga Komisioni lidhur me vlerën e mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., pas shlyerjes së detyrimit nëpërmjet kredisë prej 28.000 euro, marrë nga banka ***, si dhe kohën e kryerjes së pagesave, subjekti në përgjigjet e pyetësorit të datës ***.2.2018, deklaroi se: “...pagesat lidhur me këtë apartament janë bërë bazuar në kontratën e porosisë në periudhën 2003-2005, kur është lëvruar edhe kredia prej 28.000 euro nga banka “****”. Ndërsa në shpjegimet e mëvonshme në përgjigje të pyetësorëve të datës ***.10.2018 dhe datë ***.2.2019, subjekti shpjegon se shuma për blerjen e apartamentit është shlyer në këtë rend kronologjik në vitin 2002 – 10.000 USD, vitin 2003 – 1.700 USD dhe transfertë kredie 28.000 euro, në vitin 2004 – 4.000 USD dhe në vitin 2005 – 1.750 USD.
- 11.9 Komisioni, gjatë hetimit administrativ lidhur me kryerjen e pagesave të çmimit të kësaj pasurie, ka vërejtur se shuma e kredisë prej 28.000 euro rezulton të jetë paguar nëpërmjet transfertës bankare, në llogarinë personale të administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., më datë ***.6.2003, ndërkohë mandatpagesat e lëshuara nga shoqëria të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit kanë data të ndryshme nga ajo e transfertës bankare. Lidhur me këtë pasaktësi, subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e datës ***.2.2019 shpjegon se: “...mandatpagesat e mësipërme i ka marrë nga shoqëria ndërtuese dhe për atë nuk kishte rëndësi data e tyre, por fakti që ato provonin kryerjen e pagesës për shumën në fjalë. Gjithashtu, subjekti sqaroi se mospërputhja e datave është një lapsus i personit që i ka plotësuar ato (ekonomisti i shoqërisë ndërtuese), i cili, me sa duket, i është referuar kontratës së kredimarrjes dhe jo asaj së kryerjes së transfertës. Pra, për subjektin e rivlerësimit kishte rëndësi dokumentimi i faktit që ishte paguar vlera e apartamentit në fjalë dhe jo data e saktë e kryerjes së pagesës”.
- 11.10 Komisioni, lidhur me gjendjen faktike të përshkruar më sipër, konkludon se: “...shuma prej 28.000 eurosh, e marrë nëpërmjet kredisë së sipërcituar, ka kaluar direkt nga banka në llogarinë e administratorit të shoqërisë shitëse, më datë ***.6.2003, dhe se kredia në fjalë, së bashku me interesat e parashikuar, janë paguar rregullisht, deri në shlyerjen totale që është bërë, më datë ***.6.2010; Për këtë apartament rezultoi e paguar e gjithë shuma e parashikuar, pa u konstatuar mungesa të burimit financiar, dhe më datë ***.5.2012, ZVRPP-ja Tiranë ka lëshuar certifikatën e pasurisë, në emër të subjektit dhe të bashkëshortes së subjektit; Lidhur me mospërputhjet e datave të mandatarkëtimit të sipërpërmendur me datën e pagesës efektive të kryer, trupi gjykues vlerëson se, duke qenë një dokument i prodhuar nga një person i tretë, ato duhet të konsiderohen pasaktësi që janë kryer nga redaktuesi/plotësuesi/nënshkruesi i dokumentit, dhe nuk mund të konsiderohen si një burim përgjegjësie direkt për subjektin, për më tepër që prova e marrë

nga dokumentacioni bankar mjafton dhe prevalon mbi mandatpagesat, duke i bërë këto të fundit jo të rëndësishme në lidhje me vërtetimin e kryerjes së kësaj pagese”⁶.

- 11.11 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, konkluzioni i mësipërm nuk përputhet me situatën faktike bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje të Komisionit, pasi rrethanat ligjore që paraqiten për këtë pasuri janë të tilla që çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit z. Peka:
- i. Është kontradiktor në deklarimin e burimit të kësaj pasurie referuar *deklaratës fillestare*, dorëzuar në vitin 2004 dhe deklaratës “Vetting”, pasi në *deklaraten fillestare* deklarohet si burim i krijimit të kësaj pasurie “Kredi”, ndërsa në deklaratën “Vetting” deklarohet “Kredi” dhe “të ardhurat nga paga”;
 - ii. Lidhur me pagesat për këtë pasuri, referuar mandat-pagesave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar shlyerjen e detyrimit financiar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., në *deklaratën fillestare* dhe deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë për vitet 2004 dhe 2005, sikurse e kërkon neni 4 “dh” i ligjit nr. 9049/2003, duke kryer kështu deklaram të pasaktë.
- 11.12 Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në kuptim të nenit 30 dhe nenit 33, pika 5 “a” e ligjit 84/2016, dhe nuk shpjegon bindshëm krijimin e kësaj pasurie në kuptim të nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës.

12. Për kredinë me kushte lehtësuese nga shteti

- 12.1 **Në Deklaratën “Vetting”**, subjekti dhe personi i lidhur ka deklaruar: Apartament banimi, me sip. 59.49 m², në ***, Vlorë. *Vlera 20.000 euro (njëzet mijë). Pjesa takuese: 50%. Burimi i deklaruar i të ardhurave për banesën: (i) kredi dhe (ii) të ardhura nga paga.*
- 12.2 **Në deklaratën e interesave pasurorë privatë/vjetorë për vitin 2010** (dorëzuar më datë ***.3.2011), subjekti dhe personi i lidhur ka deklaruar: Kredi shtetërore për strehim në ***.***.*** (***) , me afat 15 vjet, me qëllim blerje apartamenti në shumën 5.000.000 lekë.
- 12.3 **Në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë për vitet 2011-2016 dhe deklaratën “Vetting”**, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ka deklaruar shlyerjen e kësteve respektive dhe detyrimin e mbetur nga kjo kredi.
- 12.4 ***Në fashikull të Komisionit ndër të tjera është administruar:***
- i. Kontratë kredi bankare me nr.*** rep. nr. *** kol., datë ***.7.2010, e lidhur para noteres ***.***, Zyra e Noterisë Tiranë me Kredihënës ***, Kredimarrës ***.***, Dorëzanës Dritan Peka [...];

⁶ Faqe 5, 6 e vendimit nr.112/2019 të Komisionit.

- ii. Kontratë shitje, pasuri e paluajtshme me nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2011, e lidhur para noterit ***.***, Zyra e Noterisë Vlorë, me *Shitës* shoqëria “****” sh.p.k., *Blerës* Dritan e *** Peka;
 - iii. Shkresë nr.*** prot., datë ***.2.2018, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
 - iv. Kontratë porosie për investim e dorëzim apartament banimi me nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.6.2010, e lidhur para noterit ***.***, Zyra e Noterisë Tiranë, me *Porositës* Dritan e *** Peka, *Sipërmarrës* “****”sh.p.k.;
 - v. Deklaratë noteriale, me objekt revokim kontratë porosie, nr.*** rep., nr.*** kol, datë ***.12.2010, mbajtur para noterit ***.***, Zyra e Noterisë Tiranë;
 - vi. Deklaratë noteriale e z. ***.***, ish-administrator i “****” sh.p.k., me nr.*** rep., *** kol., datë ***.2.2019, bërë para noterit ***.***.***, Zyra e Noterisë Tiranë;
 - vii. Dokumente shoqëruese të aplikimit për kredi me kushte lehtësuese, në emër të znj. ***.***.
- 12.5 Nga aktet në dosje të Komisionit, rezulton se personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit ka aplikuar për kredi me kushte lehtësuese nga shteti, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 12.9.2007, *“Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”* dhe i është akorduar kjo kredi.
- 12.6 Më datë ***.7.2010 është lidhur kredia me kushte lehtësuese dhe pas disbursimit të shumës është bërë transferta bankare në llogarinë e sipërmarrësit “****” sh.p.k.
- 12.7 Më datë ***.12.2010, me deklaratë noteriale të nënshkruar nga Dritan e *** Peka dhe administratori i “****” sh.p.k., është bërë revokimi i kontratës së porosisë dhe palët likuidohen dhe nuk kanë detyrim ndaj njëri-tjetrit. Kthimi i shumës së kredisë prej 5.000.000 lekë, sipas deklarimit të administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., është bërë *cash* porositësve.
- 12.8 Kjo shumë, sipas deklaratës së interesave pasurorë privatë/vjetorë të vitit 2010, ka shërbyer për porositjen e apartamentit në qytetin e ***, Vlorë, me vlerë 20.000 euro dhe shuma 700.000 mijë lekë për mobilimin dhe arredimin e këtij apartamenti, ndërsa për shumën e mbetur nga kredia nuk ka shpjegim për destinacionin e saj.
- 12.9 *Komisioni*, lidhur me gjendjen faktike të përshkruar në mënyrë të përmbledhur sa më sipër, konkludon se:
- “Nga njëra anë, kredia e butë, e marrë nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, ishte e dyshimtë nëse ajo ishte realizuar apo jo, në shkelje të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga VKM-ja nr. 600/2007, pasi nuk bëhej fjalë për një familje të pastrehë, në kuptimin e kësaj dispozite (duke pasur parasysh faktin që familja e trajtuar si e pastrehë, nga momenti që*

posedonte në qytetin e Tiranës, një apartament, me sip. 94,6 m², ndodhur në rr. “***.***”, si dhe pjesën takuese prej 1/4 e një tjetër apartamenti të ndodhur në rr. “***.***”);

Por, nga ana tjetër, duhet konsideruar edhe sa vijon:

a - Kërkesa për kredi të butë është vlerësuar dhe aprovuar nga dy institucione – Kryeministria dhe “***”-ja – të cilat kishin kompetencën dhe detyrimin që të verifikonin plotësimin ose jo të kriterëve të parashikuara nga VKM-ja nr. 600/2007, nga ana e kërkuësve, përpara sesa të kalonin kredinë në favor të tyre;

b - Fakti i mospasjes së një pronësie nga ana e subjektit⁷ dhe e bashkëshortes së tij – që mund të ishte pengesë për dhënien e kredisë së butë në favor të tyre – rezultoi i provuar;

c - Dyshimi qëndron mbi interpretimin e pikës 6, shkronja “ç”, të VKM-së nr. 600/2007, nëse togfjalëshi “...të drejta reale pasurore...” i referohet të drejtave që rrjedhin nga titulli i pronësisë apo edhe “posedimit”, pasi në rastin konkret bashkëshortët kishin një apartament në posedim⁸, por ende jo në pronësinë e tyre. Në mungesë të një interpretimi të njëzëshëm, trupi gjykues çmon se thjesht dyshimi nuk mund të penalizojë subjektin;

d - Ka qenë bashkëshortja e subjektit që ka aplikuar për kredi të butë, në sajë të “statusit të nëpunësit civil”, që ajo kishte prej vitesh⁹, dhe për rrjedhojë jo automatikisht mund të penalizohet subjekti, edhe nëse mund të jetë kryer një interpretim i gabuar ligjor nga ana e institucioneve kompetente¹⁰ apo nga bashkëshortja e subjektit;

Shuma e marrë nëpërmjet kredisë së butë, në vlerën prej 5.000.000 lekësh, fillimisht është përdorur për qëllimin e paracaktuar në kontratën e kredisë në fjalë - pra për blerjen e apartamentit (nga shoqëria “***” sh.p.k.), në Tiranë, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e bërë me “***”-në;

Pas revokimit të kontratës së porosisë me shoqërinë “***” sh.p.k. - në mungesë të një dispozite shtrënguese për të kthyer pas shumën e marrë nga kredia, bashkëshortët kanë vendosur përdorimin e pjesshëm të saj për blerjen e një tjetër apartamenti dhe pjesën tjetër për arredim. Edhe këtu mund të ketë fushë interpretimi lidhur me mundësinë e kthimit pas të shumës, te banka që kishte dhënë kredinë, por mungon një parashikim detyrues në këtë drejtim;

Për rrjedhojë, trupi gjykues - përtej dyshimeve dhe interpretimeve të ndryshme - çmon se nuk ka prova të mjaftueshme për të konkluduar se, nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe e

⁷ Në kuptimin e plotë të pronësisë, pra si pasuri e regjistruar në emër të tyre, me përjashtim të bashkëpronësisë, me pjesë takuese ¼, të apartamentit në rr. “***.***”, Tiranë, ku pjesa takuese përkon me një sip. rreth 17,75 m², dhe për rrjedhojë jo e mjaftueshme për familjen e subjektit, dhe për këtë arsye ajo mund të konsiderohet si një pengesë për marrjen e kredisë së butë. Gjithashtu, ky apartament rezultoi të jetë privatizuar nga prindërit e subjektit, më datë ***.7.1993, pra përpara sesa subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit, dhe për rrjedhojë ai nuk paraqet problematika në lidhje burimin e krijimit (kostot e privatizimit).

⁸ I cili konsiston në një rrethanë faktike, të patransformuar ende në një të drejtë të pronësisë në kuptimin e plotë të saj. Ndryshe do të ishte nëse do të bëhej fjalë për të drejtën e uzufuktit, e cila është e kornizuar nga legjislacioni civil, si një e pjesë e së drejtës së pronësisë (gëzimit të sendit), pa pasur pronësinë e sendit, por me të drejtën e përdorimit të tij, pa i ndryshuar destinacionin. Në këtë rast do të mund të konsiderohej më e plotësuar nevoja e një vendbanimi.

⁹ Konform ligjit nr. 8549/1999, neni 30 dhe VKM-ja nr. 600, datë 2.9.2007.

¹⁰ Kryeministria dhe “***”-ja që ka dhënë kredinë e butë.

bashkëshortes së tij, ka pasur një përfitimin të kredisë së butë, në kundërshtim të qartë me dispozitat normative në fuqi apo ndonjë fiktivitet kontraktor i kryer prej tyre;

Së fundmi, lidhur me këtë pikë, Komisioni, çmon se edhe në rast të një interpretimi më të gjerë të togfjalëshit "... të drejta reale pasurore...", të pikës 6, shkronja "ç", të VKM-së nr. 600/2007 - ku të përfshihej edhe "e drejta e posedimit"- në saje të argumenteve të mësipërme - dhe duke konsideruar edhe faktin që në këtë procedurë janë përfshirë edhe aktorë, kontrollues dhe autorizues të ndryshëm, kjo kredi nuk duket se do të gjeneronte një përgjegjësi të drejtpërdrejtë të subjektit të rivlerësimit, dhe gjithsesi ajo nuk mund të përbënte, në vetvete, një shkak të mjaftueshëm për aplikimin e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret".¹¹

- 12.10 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, konkluzioni i mësipërm nuk përputhet me situatën faktike bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje të Komisionit, pasi rrethanat ligjore që paraqiten për aplikimin, përfitimin dhe përdorimin e kësaj kredie me kushte lehtësuese janë të tilla që çojnë në konkluzionin se personi i lidhur znj. *** dhe, në rrjedhim, edhe subjekti i rivlerësimit z. Peka, për shkak të cilësive të marra përsipër në kontratën e kredisë (*si dorëzanës*) dhe kontratën e porosisë (*si porositës*):
- i. Kanë përfituar kredi në kundërshtim me kriteret e VKM-së nr. 600/2007, konkretisht pika 1 "e", për pozicionin *Drejtor Drejtorie*; pika 5, ku *me nevojë për strehim nënkuptohet rasti kur subjekti nuk disponon sipërfaqe banimi*; dhe pika 8 "d", ku një ndër rrethanat është *statusi i të pastrehit*. Kriteret nuk plotësoheshin, pasi znj. ***, në momentin e aplikimit (i) nuk ka mbajtur funksionin e Drejtorit të Drejtorisë, (ii) familja dispononte sipërfaqe banimi në qytetin e Tiranës, atë në rrugën "****.***", e cila nga viti 2004 e në vazhdim deklarohet si vendbanim nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, si dhe shuma e blerjes së këtij apartamenti tashmë ishte shlyer plotësisht ndaj shitësit prej disa vitesh, pra nuk ishte me statusin e të pastrehit.
 - ii. Kanë përdorur kredinë me destinacion të ndryshëm nga ai i përfitimit si apartament, *për strehim në vendin e ushtrimit të detyrës*, duke blerë apartament në qytetin e ***, Vlorë, si dhe një pjesë për arredim. Këtu subjekti i rivlerësimit paraqitet kontradiktor, pasi në deklaratën e interesave pasurore privatë/vjetorë të vitit 2010, arredimin e lidh me apartamentin në ***, ndërkohë në shpjegimet në seancë dëgjimore të datës 18.2.2019 arredimin e paraqet për apartamentin në Tiranë.
- 12.11 Në këto kushte, kjo sjellje përbën shkelje etike të figurës së prokurorit dhe e ndërlidhur me shkelje të tjera të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit 84/2016, duhet të shërbejë për vlerësimin e përgjithshëm, në drejtim të cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë sipas nenit 61, pika 5, e ligjit 84/2016.

¹¹ Faqe 8, 9 e vendimit nr. 112/2019 i Komisionit.

13. Analiza financiare

- 13.1 **Metodologjia e kryerjes së analizës financiare.** Për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, Komisioneri Publik në këtë analizë financiare është bazuar në dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga *Komisioni*, deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, Deklarata “Vetting”, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe korrespondenca e *Komisionit* me institucionet publike dhe jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet e deklaruara, dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.
- 13.2 Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar 2003 – 2016 bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat neto, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit¹² dhe bashkëshorten e tij¹³, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.
- 13.3 Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, Deklaratën “Vetting”, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.
- 13.4 Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë sa më poshtë:
- Shpenzimet e jetesës u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së dhe analizën e Komisionit.
 - Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit. Për rastet e pushimeve të kryera jashtë vendit i jemi referuar çmimeve të periudhës së udhëtimit dhe vendit të deklaruar, si dhe pagesave të kryera nëpërmjet llogarive bankare. Gjithashtu

¹² Vërtetim nga Prokuroria e Përgjithshme, për periudhën dhjetor 2016, nr. *** prot., datë ***.1.2017, dhe periudhën 2009 – 2016 me nr. *** prot., datë ***.10.2016; Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës, për vitin 2015, nr. *** prot., datë ***.10.2016; Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, periudha 2008 – 2016, nr. extra prot., datë ***.1.2017; Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, periudha 1998 – 2008, datë ***.10.2016; Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, periudha 2000 – 2003, nr. *** prot., datë ***.10.2016.

¹³ Vërtetim nga Instituti i Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës, viti 2012, nr.*** prot., datë ***.10.2016; Vërtetim nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, vitet 2006, 2010, 2016, nr.*** prot., datë ***.10.2016; Vërtetim nga *** Universiteti, vitet 2008 – 2010 dhe 2012 – 2016, nr.*** prot., datë ***.10.2016; Vërtetim nga shkolla private e arsimit të lartë “****” Vlorë, periudha 2013 – 2014, datë ***.10.2016; Vërtetim nga Kryeministria, paga neto për periudhën 1997 – 2016, nr.*** prot., datë ***.10.2016 dhe nr.*** prot., datë ***.1.2017; Shkresë Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, periudha 2011 – 2012 dhe 2015 – 2016, nr.*** prot., datë ***.1.2017; Vërtetim nga Ministria e Financave, periudha 2008 – 2010 dhe 2012 – 2013, nr.*** prot., datë ***.11.2016; Vërtetim nga Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike, periudha 2010 – 2016, nr.*** prot., datë ***.10.2016; Vërtetim nga Ministria e Mbrojtjes, periudha qershor – nëntor 2003, nr.*** prot., datë ***.10.2016.

nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar tek të afërmit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshortja kanë deklaruar udhëtime për qëllime pune.

- Shpenzimet e shkollimit, arredimit dhe riparim automjeti u bazuan në deklaratat e subjektit.
- Pagesat e kryera për këstet e kredisë janë bazuar në verifikimin e pasqyrave të lëvizjeve bankare të *** Bank deri në vitin 2010 dhe të ***.***.***, për periudhën deri në fund të vitit 2016.

13.5 Për analizimin e kursimeve *Cash* u morën në konsideratë deklaratat e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë. Në analizë janë marrë në konsideratë gjendja e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

13.6 Subjekti i rivlerësimit¹⁴, gjatë hetimit administrativ, është pyetur dhe ka dhënë shpjegimet e tij mbi gjendjen e likuiditeteve *Cash* të akumuluar në fund të çdo viti deklarues. Shpjegimet e tij nuk përputhen me gjendjen e likuiditetit *Cash* të deklaruar nga vetë subjekti në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë të vitit përkatës deklarues. Shpjegimet dhe pretendimet e subjektit mbi likuiditetet *Cash* mbeten në nivel deklarativ, për këtë arsye analiza e mëposhtme është bazuar vetëm në deklaratat e subjektit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë të depozituara pranë ILDKPKI-së.

13.7 Bazuar në nenin 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe rubrikës së deklaratës së interesave pasurorë privatë/vjetorë, “Ndryshimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, me sqarimet përkatëse, subjekti ka pasur detyrim të deklarojë shtesat dhe pakësimet të vitit deklarues.

13.8 Nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore për periudhën e hetimit pra 2003 – 2016¹⁵ dorëzuar në ILDKPI rezulton se:

- Në vitin 2006**, subjekti i rivlerësimit¹⁶ deklaroi gjendje para *Cash* në shumën 4,000 euro, konvertuar¹⁷ në 495,400 lekë, si dhe është shtuar gjendja e likuiditeteve në bankë me 972,712 lekë. Në këtë vit të ardhurat neto të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur janë në shumën 1,718,785 lekë. Në këtë vit rezulton se është blerë makina e bashkëshortes, në shumën 150,000 lekë, si dhe shpenzime të tjera,¹⁸ në total në shumën 869,314 lekë. Subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të mbuluar shumën prej – 768,641 lekë.

¹⁴ Referuar shpjegimeve në pyetësorin e depozituar në Komision me nr. *** prot., datë ***.8.2018.

¹⁵ Në vendimin nr.112, datë 4.3.2019, dhe “Relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht”, të KPK-së konstatohet se analiza financiare paraqitet deri në vitin 2009. Pra, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit i përket periudhës 2003 – 2009.

¹⁶ Subjekti nuk e deklaroi në DV 2006, por është deklaruar në DV-në e bashkëshortes, blerje makine *Nissan Micra*, në shumën 150,000 lekë.

¹⁷ Bazuar në kursin zyrtar të BSH-së 123.85 lekë/euro.

¹⁸ Shpenzime jetese dhe paguar kështu kredie ***.

- ii. **Në vitin 2010**, subjekti deklaroi *para të kursyera nga paga, në shumën 1.000.000 lekë, si dhe para të kursyera cash nga kredia e marrë në *** në shumën 1.500.000 lekë*. Në këtë vit, të ardhurat neto të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur janë në shumën 2,430,801 lekë. Gjithashtu, subjektit/bashkëshortes i është disbursuar kredia nga ***, në shumën 5,000,000 lekë, ka paguar/mbyllur kredinë me *** Bank, të deklaruar me kursimet e mëparshme në shumën 2,907,925 lekë, ka paguar apartamentin në ***, Vlorë, në shumën 20,000 euro, konvertuar¹⁹ me 2,775,400 lekë. Shpenzime të tjera²⁰ në total 2,143,579 lekë. Subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të mbuluar shumën prej - 285,021 lekë.
- iii. **Në vitin 2013**, subjekti deklaroi *para të kursyera Cash në shumën 600.000 lekë*. Në këtë vit, të ardhurat neto të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur janë në shumën 2,707,929 lekë. Gjithashtu është blerë automjeti tip BMW, prodhim i vitit 2008, në shumën 980,000 lekë, si dhe janë kryer shpenzime²¹, në total në shumën 1,801,277 lekë. Subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të mbuluar shumën prej - 480,418 lekë.
- iv. **Në vitin 2014**, subjekti deklaroi *para të kursyera Cash në shumën 900,000 lekë*. Në këtë vit, të ardhurat neto të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur janë në shumën 2,787,684 lekë. Gjithashtu, llogaria bankare është shtuar me 313,281 lekë, si dhe janë kryer shpenzime²², në total 1,881,664 lekë. Subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të mbuluar shumën prej -310,000 lekë.
- v. **Në vitin 2015**, subjekti nuk deklaroi pakësim apo shtim të gjendjes *Cash* në banesë, ndërsa llogaritë bankare rezultojnë të jenë shtuar në shumën 1,113,700 lekë. Në këtë vit, të ardhurat neto të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur janë në shumën 3,335,527 lekë. Gjithashtu janë kryer shpenzime²³ në shumën 2,616,144 lekë. Subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të mbuluar shumën prej -394,317 lekë.
- vi. **Në vitin 2016**, subjekti nuk deklaroi pakësim apo shtim të gjendjes *Cash* në banesë, ndërsa llogaritë bankare rezultojnë të jenë shtuar në shumën 874,648 lekë. Në këtë vit, të ardhurat neto të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur janë në shumën 3,196,919 lekë. Gjithashtu janë kryer shpenzime²⁴ në shumën 3,612,814 lekë. Subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të mbuluar shumën prej -1,290,543 lekë.
- 13.9 Nga sa më sipër, konstatojmë se kursimi i deklaruar dhe shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për vitet 2005, 2006, 2010, 2013, 2014, 2015, 2016, nuk mbulohej me burime të ligjshme referuar tabelës sa më poshtë:

¹⁹ Bazuar në kursin zyrtar të BSH-së, 138.77 lekë/euro.

²⁰ Përfshihen shpenzime jetese, këste kredie, udhëtime jashtë shtetit dhe arredim.

²¹ Përfshihen shpenzime jetese, këste kredie, udhëtime jashtë shtetit, riparim makine etj.

²² Përfshihen shpenzime jetese, këste kredie, udhëtime jashtë shtetit etj.

²³ Përfshihen shpenzime jetese, këste kredie, udhëtime jashtë shtetit, shkollim etj.

²⁴ Përfshihen shpenzime jetese, këste kredie, udhëtime jashtë shtetit, shkollim etj.

Tabele pëmbledhëse për vitet me rezultat negativ							
Te ardhurat dhe shpenzimet ne vite	2005	2006	2010	2013	2014	2015	2016
Gjendja në bankë fillim 01.01.	0	58,403	1,402,648	825,523	772,793	1,086,074	2,199,774
Të ardhura kredia/cash mbetur deklarua	0	0	7,274,454	0	0	0	0
Të ardhura pagat gjithsej	1,323,984	1,718,785	2,430,801	2,707,929	2,787,674	3,335,527	3,196,919
Të ardhura nga shitja makinws	200,000	0	0	140,000	0	0	0
Shpenz udhëtimi, arredim, shkoll e tjera	0	0	1,467,398	865,117	948,501	1,679,984	1,796,145
Shpenzime jetese sipas ILDKPI dhe KPK	490,482	490,482	490,482	490,482	490,482	490,482	490,482
Shpenzime shlyerje kredie	375,095	378,832	3,093,624	445,678	445,678	445,678	1,326,187
Paguar këste për apartamentin TR	180,229	0	0	0	0	0	0
Likuiditete cash te deklaruar ne fund te vitit	500,000	495,400	2,500,000	600,000	900,000	0	0
Pasuria/apartament/makine	0	150,000	2,775,400	980,000	0	0	0
Gjendja e likuiditetit ne banke 31.12	58,403	1,031,115	1,066,019	772,793	1,086,074	2,199,774	3,074,422
Mbulimi i shpenzimeve me të ardhurat	-80,225	-768,641	-285,021	-480,618	-310,268	-394,317	-1,290,543

13.10 Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, në vijim të shpjegimeve të datës 24.8.2018, ka deklaruar se gjendja e likuiditeteve Cash në banesë në fund të vitit 2016 është rreth 1,500,000 lekë. Kjo shumë nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2016 dhe as në deklaratën “Vetting”, e cila është dorëzuar në datë ***.1.2017.

13.11 Shpjegimet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, dhënë gjatë procedurës së hetimit administrativ në Komision, mbi likuiditetet Cash, mbeten në nivel deklarativ.

13.12 Në përfundim, Komisioneri Publik konstaton se nga analiza financiare e mësipërme subjekti ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3, dhe nenit 33, pika 5, germa a) e ligjit 84/2016.

II. B Vlerësimi i kriterit të aftësisë profesionale

14. Në zbatim të nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar dhe analizuar raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe ka shqyrtuar e analizuar 4 (katër) denoncime, ka konkluduar se:

“[...] pavarësisht vlerësimit pozitiv të Grupit të Punës së Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni ka konstatuar disa dyshime lidhur me aftësitë etiko-profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilat gjithsesi nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se: z. Dritan Peka ka cenuar besimin e publikut apo se ai nuk arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive të tij profesionale si prokuror;

Sigurisht që aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, si prokuror, nuk do të cenoheshin vetëm nga ndonjë pakujdesi organizuese apo neglizhencë e konstatuar në funksionin e drejtuesit, pasi në këtë rast do të mjaftonte largimi i tij nga funksioni i drejtuesit;

Por në rast se do të rezultonin të provuara dyshimet mbi favorizimet e qëllimshme, të sipërpërmendura - të aluduara lidhur me punësimin e z. ***,*** dhe mbi pagesat e kryera në favor të tij në kundërshtim me ligjin - atëherë do të ishim përballë fakteve që tregojnë mangësi

serioze etiko-profesionale, të cilat do të çonin në humbjen e besimit të publikut dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016;

*Për këto arsye dhe për të mundësuar një qartësim të dyshimeve të ngritura, trupi gjykues çmon që, në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të transferojë, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, praktikën që lidhet me përzgjedhjen dhe punësimin e z. ***,***, pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, si dhe në lidhje me kohëzgjatjen e lejes, me prezencën apo jo në vendin e punës dhe me pagesën e tij nga ky institucion, gjatë periudhës korrik - tetor 2015 [...] ²⁵.*

15. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, konkluzioni i mësipërm nuk përputhet me situatën faktike bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje të Komisionit, në të paktën 1(një) nga denoncimet e shqyrtuara nga Komisioni dhe denoncimit të përcjellë në Institucionin e Komisionerëve Publikë më datë ***.4.2019, nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Më konkretisht, për secilin prej rasteve, arsyetojmë sa vijon:

16. Denoncim i familjes * (***) e (***)**

- 16.1 *Lidhur me shkeljen e etikës profesionale, sipas dokumentacionit në dosje, për vendimin nr.***, datë ***.4.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, Prokurori i Apelit ***,*** ka informuar zyrtarisht më datë ***.4.2017 subjektin e rivlerësimit se do të ushtrohet rekurs. Pala e interesuar, familja ***, ka kontaktuar zyrtarisht me Drejtuesin e Prokurorisë dhe Prokurorin *** dhe iu është komunikuar se do të ushtrohet rekurs. Më datë ***.5.2017, në përgjigje të kërkesës së familjes ***, subjekti i rivlerësimit i njofton se nuk është bërë rekurs.*
- 16.2 Komisioneri Publik, këtë situatë faktike e analizon në dy drejtime, *së pari*: procedurat e brendshme për paraqitjen e rekursit; *së dyti*: hapat e ndërmarrë nga Drejtuesi për këtë shkelje të bërë nga Prokurori i Apelit.
- 16.3 ***Për pikën e parë***, referuar shkresës nr. ***, datë ***.11.2018, të Drejtorisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme, drejtuar Komisionit, në zbërthim të normave ligjore në fuqi, përgjegjës për ushtrimin e rekursit është Prokurori i Apelit, që përfaqëson çështjen, në rastin konkret Prokurori ***. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit, duhej të kujdesej për zbatimin me rigozitet nga Prokurori i Apelit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, që normojnë veprimtarinë e prokurorëve.
- 16.4 ***Për pikën e dytë***, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore të datës 18.2.2019, është shprehur se: *“për sa i përket masave të marra për këtë prokuror, ju thashë edhe njëherë që nuk mund të fillohet një procedim disiplinor vetëm për një çështje. Për asnjë prokuror nuk ka ndodhur asnjëherë, pra, duhet një inspektim që të nxjerrë disa probleme në një periudhë kohe, që të fillohet një procedurë disiplinore”*.

²⁵ Faqe 32 e vendimit nr.112/2019, i Komisionit.

- 16.5 Ky qëndrim nuk është në harmoni me parashikimet ligjore për kompetencat e drejtuesit të Prokurorisë sipas ligjit 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 42 “dh”, ku thuhet se drejtuesi: *“mbikëqyr disiplinën në punë të prokurorëve dhe i bën kërkesë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të prokurorëve”*. Pra rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë hapa për të informuar Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, sipas dispozitave kalimtare për procedimin disiplinor të ligjit 96/2016, “Për statusin e magjistratit”, dhe pikës 12.2 të udhëzimit nr.1/2008 të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për ushtrimin me eficiencë të së drejtës së ankimit”.
- 16.6 Ky rast, i cili lidhet me pozicionin e drejtuesit në prokurori, vlerësohet se ka ndikim në rezultatin përfundimtar të rivlerësimit të subjektit në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve sipas nenit 4, pika 2, të ligjit 84/2016.

17. Denoncim në IKP, lidhur me shkeljen e etikës profesionale

- 17.1 Më datë ***.4.2019, nga Kolegji është përcjellë një denoncim anonim, për subjektin e rivlerësimit lidhur me qëndrimin e mbajtur prej tij në çështjen gjyqësore pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket të pandehurit ***.***, akuzuar për veprën penale të mashtrimit. Sipas fotokopjes së vendimit të Gjykatës së Apelit nr.***, datë ***.2.2019, subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë nga ankimi në mënyrë paraprake.
- 17.2 Komisioneri Publik, këtë situatë faktike të heqjes dorë nga ankimi e analizon në dy drejtime:
- Së pari**, në drejtim të *anës procedurale*, e cila është parashikuar në Kodin e Procedurës Penale, neni 418, pika 1, ku thuhet se heqja dorë nga ankimi mund të bëhet “...*deri para fillimit të diskutimit përfundimtar*”, subjekti i rivlerësimit ka vepruar konform kësaj dispozite.
- Së dyti** në drejtim të *anës procedurale të brendshme dhe analizën e rastit*, referuar ligjit nr. 97/2016, neni 6, pika 2, ku thuhet se “*Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji*”, si dhe udhëzimit nr. 1/2008 i Prokurorit të Përgjithshëm, pika 7.2, ku thuhet: “*Kur ankimi është ushtruar nga drejtuesi i Prokurorisë, njoftimi për heqjen dorë nga ankimi dhe analiza përkatëse e rastit do të bëhet me drejtuesin e Prokurorisë të një shkalle më lartë*”, nuk mund të shprehem për zbatimin e tyre nga subjekti i rivlerësimit.
- 17.3 Për këtë rast, ndodhur në kushtet e mungesës së informacionit për arsyet e heqjes dorë nga ankimi, si dhe procedurën e ndjekur, ky denoncim i bashkohet ankimit të Komisionerit Publik për t’u trajtuar më tej nga Kolegji.

II. C Vlerësimi i kriterit të kontrollit të figurës

18. Në zbatim të nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të

Klasifikuar, ka konkluduar se: *subjekti është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.*

19. Më datë 15.4.2019, në postën elektronike të institucionit të Komisionerit Publik, ka mbërritur denoncimi: “Një informacion në lidhje me subjektin e verifikimit në procesin e Vetting-ut, z. Dritan Peka, prokuror/drejtues i Prokurorisë së Apelit Tiranë”. Ky denoncim ngre dyshime lidhur me komunikime dhe kontakte të shpeshta me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
20. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, duke qenë se kriteri i kontrollit të figurës përbën një nga kushtet kumulative për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, të dhënat e këtij denoncimi duhen verifikuar nga ana e Kolegjit gjatë shqyrtimit të ankimit, në pamundësi objektive të verifikimit nga Komisioneri Publik, i cili nuk ka akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.

III. Kërkimi i ankimit

21. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe çmim të drejtë të provave të administruara;
22. Në funksion të kërkimit të ankimit, Komisioneri Publik, nisur nga roli që Kushtetuta i njeh si përfaqësues i interesit publik në procesin e rivlerësimit, referuar instrumentit procedural (ankim) që Kushtetuta i ka njohur për të aktivizuar juridiksionin kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, në rastet kur kërkohet ndryshimi i vendimit të konfirmimit për subjektin e rivlerësimit, vendim ky (konfirmimi në detyrë) që nga organet e rivlerësimit (Komisioni dhe mbi ankimin e Komisionerit, Kolegji) merret vetëm pas çmuarjes njëkohësisht të secilit prej kritereve (pasuri, profesionalizëm, figurë), në mënyrë të pavarur dhe pas vlerësimit tërësor të tyre, çmon se juridiksioni i Kolegjit në kontrollin/rivlerësimin e vendimit të Komisionit do të duhet të ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit;
23. Në këtë mënyrë, si një ndër burimet e provës të parashikuara nga ligji nr. 84/2016, denoncimet e publikut, por jo vetëm, mund të shërbejnë për rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit në të tria kriteret e përcaktuara në Kushtetutë dhe eventualisht konfirmimin ose jo të subjektit të rivlerësimit, deri në momentin që vendimi i Komisionit ende nuk përbën *res judicata* në tërësinë e tij, për shkak të ushtrimit të ankimit të Komisionerit Publik. Juridiksioni kontrollues/rivlerësues që i njihet Kolegjit dhe zhvillimi i gjykimit të ankimit të Komisionerit Publik në seancë publike, duke i dhënë të gjitha të drejtat për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur subjektit të rivlerësimit, do të garantonin në çdo rast respektimin e elementeve të procesit të rregullt ligjor;
24. Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimet e nenit 179/b (5) të Kushtetutës, nenit C (2), Ç, D, DH, E dhe F (7), të aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në vendimin nr.112/2019, referuar gjendjes së

fakteve dhe provave, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se për subjektin e rivlerësimit gjen zbatim neni 59/1 i ligjit nr. 84/2016;

25. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 dhe 7 e aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, pas hetimit të plotë për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Peka, në përfundim të gjykimit të çështjes, në bazë të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 112, datë 4.3.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, zotin Dritan Peka dhe shkarkimin e subjektit nga detyra.

KOMISIONERI PUBLIK

DARJEL SINA